

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Në pajtim me nenin 108/A paragrafi 14 sipas nënparagrafit 2 të paragrafit 10, nenin 109 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, nenin 3.3 dhe 8.3 për Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 lidhur me nenin 109 paragrafi 1 të LPP-së, brenda afatit ligjor¹ paraqesim këtë:

ANKESË

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VITISË**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr. i prokurimit GL-657-21-8891-2-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Nr i brendshëm: VI657-21-006-211

Sa i përket tenderit me titull: **"Shërbimet e pastrimit mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë – Ritender"**,

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i OE: **"EL-BAU" shpk**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Nato 99

(Adresa)

Gjilan, Kosovë

60000

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it) **049 244 330**

19.11.2021

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës e parashtro ankesën vetëm

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi

për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për Kontratë në KRPP me dt. 11.11.2021
- Lloji i procedurës së aplikuar Procedurë e Hapur
- Lloji i kontratës – shërbime
- Vlera e parashikuar e kontratës 440,000.00 euro;
- Kriteri për dhënien e kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët;
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave përmes platformë elektronike 25.11.2021
- Data e hapjes së tenderëve 25.11.2021
- Kerkese për Rishqyrtim e dates 19.11.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

☐

Jo

☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vitisë me vendosjen e procesurës së poentimit të çmimeve në rastin konkret kur dihen sasi të indikative, ka vepruar në shkelje të parimeve bazike dhe shkelje të dispozitave qenësore të LPP-së si në vijim:

1. Neni 7 par.1, 2 dhe 4 (Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;
2. Neni 38 (Kontratat Kornizë) i LPP-së nr.04/L-042
3. Neni 18.28 dhe 56.15 të RrUOPP;
4. Neni 44 par.2.1 dhe neni 46 par.2.1 i LPP-së nr.04/L-042
5. Nenit 51 par.1. dhe 2 (Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes) i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 26.4 të RrUOPP;
6. Neni 28 të LPP-së lidhur me nenin 20 të RrUOPP;

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datën 11.11.2021, AK- Komuna e Vitisë në platformën e-prokurimi ka publikuar lëndën e prokurimit, kontratë kornizë me një operatorë ekonomik dhe materialin tenderik për aktivitetin e prokurimit: **“Shërbimet e pastrimit mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë – Ritender”.**

Pretendimi Nr.1.

Kërkesa lidhur me stafin profesional – Menagjer i Projektit **“Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, Drejtimi i Mjedisit ose Master i Ekologjisë – me min 3 vite përvojë pune pas diplomimit”**

Për të njëjtin aktivitet të prokurimit (me lëndën dhe objektin e njëjtë të punës), në dosjen e tenderit të dt. 05.02.2021, kërkesa e AK-së ka qenë e ndryshme nga

kërkesa e tanishme. Sipas kërkesës paraprake është kërkuar Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarise – drejtimi konstruktiv me min. 5 vite pervoje pune pas diplomimit. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me lëndën dhe objektin e njejtë të punës, shtrohet pyetja se cilat janë arsyet/shkaqet dhe relevanca që AK e ka ndryshuar kërkesën në fjalë nga drejtimi konstruktiv në drejtimin e mjedisit ose Master i Ekologjisë. Konsiderojmë se ndryshimi i kërkesës nga drejtimi konstruktiv në drejtimin e mjedisit (drejtim i cili nuk eksizton fare në UP) është bërë duke iu përshtatur ndonjë OE të caktuar dhe kufizuar konkurencën në raport me OE tjerë ekonomik.

Së dyti, në Univesritetin e Prishtinës, Fakultetin e Ndërtimtarisë nuk ka drejtim/program të Mjedisit. Në këtë fakultet janë këto programe: Konstruksiione, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit. Sipas planprogramit mësimor të nivelit Bachelor Inxhinieri e Ambientit, **lënda Inxhinieri ndërtimi dhe ambienti përmban:** *Menaxhimi i ujit urban; Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur; Menaxhimi i mbeturinave të ngurta; Mbrojtja dhe përforcimi i dherave; Termodinamika inxhinierike; Sistemet fushore të trajtimit të ujit të ndotur, dhe të tjera zgjedhore.* Pra në rastin konkret kërkesa e AK-së nuk është drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale pasi që punët të cilat kërkohen në përshkrimin e projektit të dosjes së tenderit nuk janë punë që i përkasin drejtimin në fjalë.

Prandaj, për këto arsye kërkojmë që kërkesa për menagjerin e e projektit Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarise – drejtimi mjedisit ose Master i Ekologjisë me min. 3 vite pervoje pune pas diplomimit të ndryshohet dhe zavendësohet me Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarise – drejtimi konstruktiv me min. 3 vite pervoje pune pas diplomimit.

Pretendimi Nr.2.

Kërkesa lidhur me pajisjen teknike Min. 1 eskavator me peshe deri ne 1.7 ton, në mënyrën siç është specifikuar, është kërkesë kufizuese e cila kufizon konkurencën në mes OE të interesuar për tenderim, kufizon pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik dhe në anën tjetër favorizon një apo më shumë operatorë ekonomik.

Autoriteti kontraktues me rastin e përcaktimit të peshës dhe specifikave të tjera të mjeteve dhe pajisjeve teknike, nuk duhet që ato t'i përcaktojë dhe specifikojë sipas konsideratave tjera mirëpo duhet të bazohet në klasifikimin ndërkombëtar të mjeteve përkatëse. Sipas klasifikimit ndërkombëtar ekskavatorëve, të gjithë ekskavatorët (makina të dizajnuara për të gërmuar dhe lëvizur tokën) është i përcaktuar sipas ndarjes në grupet e mëposhtme sipas

madhësive dhe kapacitetit të tyre sipas rregullit ndahen në grupet e mëposhtme: 1). **mini eskavatorë** - me peshë deri në 5 ton, 2) **midiekskavatorë** - me peshë deri në 8 ton, 3) **ekskavatorë ndërtimi** me madhësi të plote që peshojnë deri në 40 ton, dhe 4) **ekskavatorë ndërtimi** me madhësi të plote që peshojnë mbi 40 ton

Pretendimi Nr.3.

Kërkesa lidhur me pajisjen 1 (nje) dhe rimorkio me peshe bartese deri 2 ton, në mënyrën siç është specifikuar, është kërkesë kufizuese e cila kufizon konkurrencën në mes OE të interesuar për tenderim, kufizon pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik dhe në anën tjetër favorizon një apo më shumë operatorë ekonomik.

Autoriteti kontraktues me rastin e përcaktimit të peshës dhe specifikave të tjera të mjeteve dhe pajisjeve teknike, nuk duhet që ato t'i përcaktojë dhe specifikojë sipas konsideratave tjera mirëpo duhet të bazohet në klasifikimin ndërkombëtar të mjeteve përkatëse. Sipas klasifikimit ndërkombëtar **të mjeteve të transportit rrugor sipas konstruksionit bartës nga kapaciteti i mbajtjes peshës eksistojnë klasifikimet e mjeteve të transportit sipas grupeve të mëposhtme: 1) E vogël - nga 05 deri në 2 ton; 2) E mesme - nga 2 deri në 5 ton, dhe 3) E veçantë apo e madhe - prej 16 ton e tutje.**

Në rastin konkret, bazuar në natyrën e përshkrimit të projektit që është objekt i kontratës, kushteve të infrastrukturës rrugore, punët mund të kryhen me cilësi të lartë sipas standardeve edhe me rimorkio mbi 2 ton deri në 5 ton

Për këto arsye kjo kërkesë është kufizuese, prandaj kërkojmë nga AK që kërkesën **rimorkio me peshë bartëse deri 2 ton, ta ndryshoj dhe zavendësoj me rimorkio deri në 5 ton**

Pretendimi Nr.4.

Në dosjen e tenderit janë të përcaktuara sasi të indikative/të përafërta e në anën tjetër krieter për dhënien e kontratës është përcaktuar çmimi i poentuar për njësi. Vlen të potencohet se në tenderin e njëjtë paraprak (2019-2020) ka lënda dhe objekti i kontratës është i njëjtë nuk ka qenë kriter poentimi i çmimeve me njësi.

Prandaj në rastin konkret në vështrim të bazës ligjore AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 38 të LPP-së dhe nenit 18.28 dhe 56.15 të RRUOPP për faktin se procedura e poentimit nuk mund të përdoret tek kontratat kornizë kur dihet/janë të njohura sasi të indikative me mospërputhjen +/- 30%.

Sipas nenit 56.15 të RRUOPP përcaktohet se procedura e poentimit të çmimit përdoret

për prokurimin publik për ato aktivitete kur autoriteti kontraktues **nuk e di** sasinë indikative të artikujve që do të porositen dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë "1". Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin 100%. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavan plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Përmes ekzekutimit të këtij kriteri AK redukton konkurrencën e drejtë dhe të ligjshme në mes OE, dhe gjatë vlerësimit mund të diskriminon në dëm të më shumë operatorëve ekonomik dhe favorizon OE të caktuar që për rrjedhojë mund të manipulohet me çmime duke ju dhënë peshë artikujve që nuk janë të rëndësishëm. Ndërsa në anën tjetër i shkaktohen dëme financiare AK-së.

Prandaj autoriteti kontraktues duhet të ndërmarrë masa ligjore ndaj zyrtarit/ve përkatës të cilët kanë përgatitur kërkesat e tilla diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së të cilat shkelin parimin e barabarsisë dhe mund t'i shkaktojnë dëme financiare AK-së. AK duhet të vendosin kërkesa dhe kriteret me kusht që ato mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se si në rastin konkret.

Rrjedhimisht AK duhet të ndërmerr masat e nevojshme që të heq nga dosja e tenderit këtë kriter i cili bie ndesh me dispozitat e LPP-së dhe RRUOPP si rezultat i aplikimit të paligjshëm të procedurës së poentimit të çmimit për njësi kur sasinë indikative dihen dhe janë të njohura për AK-në.

Pretendimi Nr.5.

Me datën 11.11.2021 në platformën e-prokurimi është publikuar njoftimi për kontratë si dhe materiali tenderik. Afati i caktuar nga AK për pjesëmarrje dhe dorëzimin e dosjes së tenderit nga OE është përcaktuar të jetë me datën 25.11.2021.

Edhe kjo kërkesë procedurale është bërë duke shkelur afatet ligjore të kërkesave për pjesëmarrje nga neni 44v par.2.1 që përcaktohet se **kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë.**

Po ashtu përkundër faktit se asnjë urgjencë dhe rrethanë për zbatimin e afateve të përshpejtuara, me këtë rast janë shkelur edhe rregullat e posaqme për shkurtimin e afateve kohore të përcaktuara nga neni 45 dhe 46 i LPP-së.

Afati kohor i përcaktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve nuk është i mjaftueshëm për t'iu dhënë operatorëve të interesuar ekonomik kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet në fjalë.

Prandaj kërkohet nga AK që ta korrigjojë këtë shkelje dhe të caktojë një afat të ri duke pasur parasysh kërkesat ligjore dhe duke marrë parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e përgatitjes së një tenderi, të përgjegjshëm ose kërkesë për pjesëmarrje.

Andaj duke u bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga AK-Komuna e Vitisë të marrë vendim në atë mënyrë që të **PRANOHET** e bazuar Ankesa e OE ankues EL-BAU në atë mënyrë që të hiqet nga dosja e tenderit poentimi i çmimit për njësi pasi sasi të indikative dihen dhe janë të njohura për AK dhe të caktohet afat i ri pjesëmarrjes/pranimit të tenderëve në pajtim me LPP-në.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik ankues në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara me larte.

